



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation



Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë

Në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-135 për veprimtari kërkimore-shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), dhe Pëlqimit të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) nr. 01B-195 dt. 31.10.2024, Këshilli drejtues i Institutit të Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë, miraton:

STATUTIN E INSTITUTIT TË HISTORISË “ALI HADRI” - PRISHTINË

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Subjektiviteti juridik

1. Instituti ka cilësinë e personit juridik kërkimor-shkencor.
2. Instituti i Historisë (në vazhdim Instituti) është institucion i pavarur publik kërkimor - shkencor i lëmisë së historisë, i cili veprimtarin e zhvillon në bazë të Ligjit për veprimtari kërkimore-shkencore nr. 04/L-135 i datës 28.03.2013.
3. Emri zyrtar i Institutit është: Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë.
4. Instituti ka selinë në Prishtinë.
5. Instituti ka vulën e vet, me tekstin brenda saj në tri gjuhë (shqip, serbisht dhe anglisht): Republika e Kosovës, Instituti i Historisë, “Ali Hadri-Prishtinë”.
6. Instituti ka logon e vet, e cila vihet në vula, në shkresa, publikime shkencore të Institutit dhe në mbishkrime. Republika e Kosovës, Instituti i Historisë, “Ali Hadri-Prishtinë”. (Njëjtë sikurse vula).
7. Përdorimi dhe ruajtja e të gjitha vulave do të rregullohet me aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli drejtues i Institutit.
8. Instituti ka faqen e vet zyrtare në internet.
9. Obligimet juridike të Institutit burojnë nga Kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Kosovës.
10. Instituti mund të marrë obligime në marrëdhëniet juridike, në përputhje me Legjislacionin në fuqi dhe Statutin e Institutit.

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEHNOLOGJIE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.
<u>01B</u>	<u>3213</u>
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Data: Datum: Date:
<u>19</u>	<u>31.10.2024</u>
Prishtinë - A	

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA INSTITUTI I HISTORISË-INSTITUTE OF HISTORY-INSTITUT ZA ISTORIJU	
Njësia Org. Org. Unit Org. Jed.	Nr. I prot. Prot. N. Br. Prot.
<u>1. H</u>	<u>01/82/24</u>
Nr. i Faqeve No. Pages Br. Stranica	Data: Date: Datum:
<u>18</u>	<u>01.11.2024</u>
PRISHTINË - A	

Veprimtaria e Institutit të Historisë

Neni 2

Natyra e veprimtarisë

1. Instituti kujdeset për ngritjen e kapaciteteve kërkimore-shkencore të kuadrit shkencor dhe hulumtues.
2. Instituti organizon dhe zhvillon veprimtarinë në fushën e publikimeve si dhe të informimit kërkimor-shkencor.
3. Instituti bashkëpunon me institucionet kërkimore-shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim të ndërlidhjes dhe shfrytëzimit të përvojave të punës kërkimore-shkencore dhe arsimore dhe të shfrytëzimit të përvojave të njëri tjetrit për hulumtime multidisiplinare.
4. Instituti merret me ndërlidhjen e shkencës dhe arsimit të lartë nëpërmjet bashkëpunimit me universitetet dhe institucionet tjera të arsimit të lartë.

Neni 3

Realizimi i veprimtarisë

1. Veprimtaria kërkimore-shkencore nga lëmi i historisë realizohet përmes punës krijuese sistematike që ndërmerret me qëllim të kërkimit dhe të zhvillimit të njohurive të reja, të shfrytëzimit dhe të zbatimit të tyre në praktikë.
2. Veprimtaria kërkimore-shkencore përfshinë veçanërisht kërkimet shkencore, hulumtimet në arkiva dhe terren, publikimin e rezultateve të tyre, përgatitjen dhe aftësimin e kuadrove për punë kërkimore-shkencore dhe ndërtimin e infrastrukturës kërkimore.

Neni 4

Projektet shkencore

1. Punonjësit e Institutit merren me realizimin e projekteve:
 - 1.1. Projekte individuale dhe kolektive;
 - 1.2. Projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 5

Parimet e veprimtarisë themelore të Institutit të Historisë

1. Veprimtaria themelore e Institutit mbështetet në këto parime:
 - 1.1. Të lirisë së veprimtarisë kërkimore-shkencore;
 - 1.2. Të punës publike;
 - 1.3. Të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale;
 - 1.4. Të konkurrencës së projekteve kërkimore-shkencore;
 - 1.5. Të pacenueshmërisë dhe të sigurisë së aftësive të njeriut dhe të dinjitetit të tij;
 - 1.6. Të etikës dhe të përgjegjësisë së punëtorit shkencor dhe të hulumtuesit për pasojat e punës së tij;
 - 1.7. Të ndërlidhjes së kërkimeve shkencore dhe të shkollimit të lartë;
 - 1.8. Të përfshirjes në veprimtarinë kërkimore-shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 6

Përfshirja e veprimtarisë themelore të Institutit

1. Veprimtaria themelore e Institutit përfshinë:
 - 1.1. Hulumtimin dhe studimin e historisë, historisë kombëtare dhe me theks të veçantë atë të Kosovës që nga parahistoria e deri në ditët e sotme;
 - 1.2. Udhëheqjen dhe organizimin e punëve kërkimore-shkencore e profesionale nga lëmi i historisë;
 - 1.3. Zhvillimin e mendimit teorik, kritik dhe mbi historiografinë dhe të bëjë vlerësimin dhe zbatimin e rezultateve kërkimore-shkencore në fushën e historisë;
 - 1.4. Përgatitjen dhe realizimin e projekteve kërkimore-shkencore, profesionale dhe edukativo-arsimore;
 - 1.5. Botimin e rezultateve kërkimore - shkencore përmes revistave, monografive, botimeve të veçanta, studimeve, botimeve digjitale, etj;
 - 1.6. Organizimin e këshillimeve, diskutimeve, seminareve, punëtorive, prezantimeve, ekspozitave, tryezave të rrumbullakëta, simpoziumeve, konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, kongreseve etj.
2. Për atë që lejon natyra e punëve, Ligji dhe aktet e tjera relevante, Instituti kryen edhe veprimtari të tjera.

Neni 7

Infrastruktura kërkimore - shkencore

1. Infrastruktura kërkimore-shkencore përfshinë: objektet, pajisjet dhe shërbimet e domosdoshme për veprimtarinë kërkimore-shkencore, arkivin, bibliotekën, kinotekën, fototekën, laboratorët kërkimorë-shkencorë, literaturën elektronike, bazën e të dhënave etj.

Neni 8

VEPRIMTARIA BOTUESE

Botimet e Institutit të Historisë

1. Instituti boton revistën shkencore "KOSOVA".
2. Përveç botimit të revistës nga paragrafi 1, Instituti boton: monografi, përmbledhje dokumentesh, studime, kritikë historiografike, kronologji, bibliografi si dhe botime të tjera të veçanta nga lëmi i veprimtarisë historiografike.
3. Revista KOSOVA, botohet në secilin vit kalendarik. Publikimi i saj do të realizohet në gjysmën e parë të vitit pasues, pas dorëzimit të dorëshkrimeve të punimeve, përzgjedhjes, recensimit dhe sistemimit përkatës.
4. Numri tematik i revistës KOSOVA, në gjuhën angleze do të botohet një herë në katër vite.
5. Çështja e botimeve të Institutit parashihet me rregullore të veçantë dhe duhet bazuar në aktet ligjore të ministrisë për shkencë, për njohjen e platformave ndërkombëtare.

Organizmi dhe përbërja e Institutit

Neni 9

Organizimi

1. Instituti përbëhet prej Departamenteve shkencore dhe Departamenti të shërbimeve të përgjithshme.
2. Instituti ka gjithsejtë pesë (5) Departamente shkencore:
 - 1.1. Departamenti Antikës;

- 1.2. Departamenti i Mesjetës;
- 1.3. Departamenti i Kohës së Re;
- 1.4. Departamenti i Kohës Bashkëkohore;
- 1.5. Departamenti i Historisë kulturore dhe studimeve gjinore;
3. Departamenti i shërbimeve të përgjithshme përbëhet nga:
 - 1.5.1. Divizioni për buxhet dhe financa;
 - 1.5.2. Divizioni për prokurim;
 - 1.5.3. Divizioni për përkrahjen profesionale-teknike të punës kërkimore dhe shkencore, i cili përfshinë:
 - 1.5.3.1. Arkivin;
 - 1.5.3.2. Bibliotekën;
 - 1.5.3.3. Laboratorët;
 - 1.5.3.4. Kinotekën;
 - 1.5.3.5. Fototekën dhe
 - 1.5.3.6. Fonotekën.
5. Në bazë të strategjive zhvillimore të mëvonshme Institutit mund t'i shtohen apo hiqen shërbime të caktuara.

Neni 10

Veprimtaria e departamenteve shkencore

1. Departamentet shkencore organizojnë dhe kryejnë punë kërkimore-shkencore të specializuara në fushën e historisë.
2. Në kuadër të departamenteve shkencore, veprimtaria kërkimore-shkencore realizohet përmes projekteve shkencore në të cilat janë të angazhuar punonjësit shkencor dhe hulumtuesit.
3. Në kuadër të departamenteve shkencore zhvillohen këto aktivitete:
 - 3.1. Hulumtimet kërkimore-shkencore në arkiva brenda dhe jashtë vendit;
 - 3.2. Organizimi dhe koordinimi i projekteve shkencore;
 - 3.3. Organizimi i veprimtarive hulumtuese më institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtar;
 - 3.4. Organizimi i veprimtarive në terren;
 - 3.5. Organizimi i hulumtimeve laboratorike;
 - 3.6. Organizimi i takimeve shkencore dhe profesionale;
 - 3.7. I propozon drejtorit dhe Këshillit shkencor aktivitetet shkencore;
 - 3.8. Ofrimi i ekspertizave dhe këshillave profesionale;
 - 3.9. Aktivitete të tjera nga fushë veprimtaria e Institutit;
 - 3.10. Departamenti shkencor mund t'i propozon drejtorit-es rritjen e numrit të kuadrit shkencor për departamentin.
4. Mënyra e organizimit, bashkëpunimit, dhe kryerja e veprimtarive kërkimore-shkencore të përbashkëta përcaktohet me rregullore të veçantë.

Neni 11

Zgjedhja e shefit të departamentit kërkimor-shkencor dhe profesional

1. Këshilli shkencor i zgjedh shefat e departamentit pas propozimeve nga drejtori-ja dhe anëtarët e tjerë të Këshillit shkencorë.
2. Kandidatët për shefa të departamenteve shkencore paraqesin planin e punës i cili duhet të miratohet së bashku me kandidaturën e tyre në Këshillin shkencorë.

3. Kandidatët për shefa të departamenteve shkencore duhet të kenë thirrjen Bashkëpunëtor shkencorë e sipër.
4. Mandati i Shefit të departamentit është katër vjet.
5. I njëjti person mund të rizgjidhet edhe për katër vite të tjera.
6. Shefat e departamenteve shkencore mund të shkarkohen me të njëjtën procedurë të zgjedhjes.
7. Shefi i departamentit përgatit raport me shkrim për realizimin e planit vjetor të punës së departamentit.
8. Shefi i departamentit është anëtar i redaksisë së revistës Kosova.
9. Shefi i departamentit nuk mund të jetë anëtar i Këshillit Drejtues.
10. Shefi i departamentit i përgjigjet dhe i raporton drejtorit-es.
11. Shefi i Departamentit kompensohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 12

Punët dhe përgjegjësitë e shefit të departamentit kërkimor-shkencor

1. Shefi i departamentit i kryen këto punë:
 - 1.1. Udhëheq dhe organizon punën kërkimore-shkencore të departamentit;
 - 1.2. Propozon planin e punës kërkimore-shkencore të departamentit;
 - 1.3. Përgjigjet për realizimin me kohë të detyrave të departamentit, të parapara me plan të punës;
 - 1.4. Shefi i departamentit është i obliguar që para fillimit të vitit të ri të punës t'i prezantoi drejtorit-es një plan-program të harmonizuar të departamentit, respektivisht të punonjësve shkencor dhe hulumtuesve të tij.
 - 1.5. Në bashkëpunim me drejtorin-en dhe sekretarin shkencor, bashkërendon punën e grupeve ose të individëve, të cilët janë të inkuadruar në realizimin e projekteve kërkimore-shkencore të departamentit;
 - 1.6. Përgatit, thërret dhe kryeson mbledhjet e departamentit dhe kujdeset për mbajtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit të departamentit;
 - 1.7. Në bashkëpunim me drejtorin-en, ose sipas kërkesës së drejtorit-es, kontakton me institucionet dhe bashkëpunëtorët brenda dhe jashtë vendit;
 - 1.8. Përgatit raport me shkrim për realizimin e planit vjetor të punës së departamentit;
 - 1.9. Me kërkesë të drejtorit, përgatit raport ad-hoc për punën e departamentit.
 - 1.10. Shefi i Departamentit i propozon Drejtorit nevojat për rritjen e numrit të kuadrit shkencor ose angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për departamentin;
 - 1.11. Shefi i Departamentit i përgjigjet dhe i raporton Drejtorit;
 - 1.12. Shefi i Departamentit i raporton çdo 6 muaj ose sipas kërkesës Këshillit Shkencor;
 - 1.13. Propozimi i temave të reja të projekteve shkencore do të bëhet fillimisht nga ana e departamentit përkatës.

Neni 13

Departamenti i shërbimeve të përgjithshme

1. Instituti ka Departamentin e shërbimeve të Përgjithshme, i cili kryen punë administrative, profesionale, financiare dhe teknike.
2. Staf i profesional, administrativ, financiar dhe teknik zgjedhet në bazë të Ligjit për zyrtaret publik të Republikës së Kosovës, dhe akteve tjera në fuqi.
3. Vendimin për pranimin në punë të të gjithë punonjësve: administrativë, financiarë, teknikë dhe logjistikë, e merr drejtori, në bazë të propozimit të komisionit intervistues-vlerësues.
4. Organizimi i punëve në Shërbimin e Përgjithshëm, përcaktohet më gjerësisht me rregullore të brendshme të punës së Institutit, sipas Ligjit për zyrtaret publik të Republikës së Kosovës.

Neni 14
Sekretari i Institutit

1. Në krye të Departamentit të shërbimeve të përgjithshme qëndron Sekretari i Institutit.
2. Sekretari i Institutit ka këto kompetenca:
 - 2.1. Mbikëqyrë veprimtarinë e Administratës;
 - 2.2. Përkujdeset për mbarëvajtjen e procedurave të rekrutimit;
 - 2.3. Përkujdeset për zbatimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e Institutit;
 - 2.4. Është anëtar i Këshillit shkencor, pa të drejtë vote.
3. Sekretari i Institutit mund të zgjedhet personi i cili është jurist i diplomuar dhe ka së paku pesë vjet përvojë në organizimin e punëve juridike, administrative dhe profesionale.
4. Sekretari për punën e vet i përgjigjet dhe i raporton drejtorit-es.
5. Sekretari është i obliguar, në aspektin administrativ, ligjor dhe profesional, të përpiloj vendimet e të Këshillit drejtues, drejtorit-es dhe Këshillit shkencor dhe të Institutit.

Neni 15

Menaxhimi i departamenteve

1. Në përputhje me këtë Statut dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, drejtori i Institutit është përgjegjës për udhëheqjen dhe menaxhimin e departamenteve.

ORGANET DREJTUESE TË INSTITUTIT

Neni 16

Organet drejtuese të Institutit

1. Organet drejtuese të Institutit janë:
 - 1.1. Këshilli drejtues;
 - 1.2. Këshilli shkencor;
 - 1.3. Drejtori.

Neni 17
Këshilli drejtues

1. Këshilli drejtues është organ kolegjal i qeverisjes së Institutit, ashtu siç përcaktohet me ligj.
2. Këshilli drejtues i Institutit përbëhet prej pesë (5) anëtarësh.
3. Drejtori i Institutit është anëtarë dhe kryesues i Këshillit drejtues.
4. Ministria përkatëse për shkencë emëron dy (2) anëtarë të Këshillit drejtues që kanë thirrje shkencore.
5. Dy anëtarë të Këshillit drejtues zgjidhen njëri nga radhët e departamenteve të shkencës dhe tjetri nga radhët e departamentit të administratës.
6. Zgjedhja e anëtarëve bëhet nga të gjithë punonjësit e Institutit me votim të fshehtë.
7. Anëtarët e Këshillit drejtues mund të shkarkohen me të njëjtën procedurë të zgjedhjes.
8. Organizimi dhe puna e Këshillit drejtues përcaktohet me rregullore të veçantë.
9. Në të gjitha mbledhjet e Këshillit drejtues mbahet procesverbal.
10. Këshilli drejtues, me këtë Statut dhe me rregullore të tjera, rregullon organizimin, administrimin dhe mbikëqyr funksionimin e Institutit.
11. Mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues është katër (4) vjet, me mundësi rizgjedhje vetëm edhe për një mandat.

Neni 18
Kompetencat e Këshillit drejtues

1. Këshilli drejtues ka këto kompetenca:
 - 1.1. Miraton aktet normative të Institutit;
 - 1.2. Harton dhe nxjerr- miraton Statutin e Institutit;
 - 1.3. Miratimi i Statutit bëhet sipas Legjislacionit në fuqi;
 - 1.4. Harton dhe miraton rregulloren e vet të punës;
 - 1.5. Miraton politikat dhe strategjitë zhvillimore të Institutit;
 - 1.6. Miraton planin e punës dhe atë financiar të Institutit;
 - 1.7. Miraton raportin vjetor të punës dhe raportin financiar të Institutit;
 - 1.8. Zgjedh, mbikëqyr dhe shkarkon drejtorin-en e Institutit;
 - 1.9. Ndërmerr masa për organizimin dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të Institutit;
 - 1.10. Për punën e vet përgatit raport me shkrim i cili është publik për ministrin-en, në bazë vjetore ose sipas kërkesës së ministrit/es.i cili është publik.
 - 1.11. Vendimet e Këshillit Drejtues duhet të zbatohen derisa nuk shfuqizohen nga vetë Këshilli drejtues apo nga instanca më e lartë, respektivisht Ministria përkatëse për shkencë;
 - 1.12. Këshilli Drejtues, me këtë Statut dhe me rregullore të tjera, rregullon organizimin, administrimin dhe mbikëqyr funksionimin e Institutit;

Neni 19
Vendimmarrja

1. Mbledhjet e Këshillit drejtues, i thërret dhe i udhëheqë drejtori-ja i Institutit.
2. Nëse për shkaqe të arsyeshme drejtori-ja nuk mund të marr pjesë në mbledhje apo në rend dite shqyrtohen çështje që paraqesin konflikt interesi për drejtorin-en, mbledhjen e udhëheq Sekretari shkencor i Institutit.
3. Drejtori-ja i thërret mbledhjet sipas nevojës. Brenda një muaji duhet të mbahet të paktën një mbledhje.
4. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren në çfarëdo kohe sipas procedurave të parapara.
5. Mënyra e organizimit të punës së Këshillit Drejtues përcaktohet me rregullore të veçantë, të miratuar nga vet Këshilli.
6. Në të gjitha mbledhjet e Këshillit Drejtues, mbahet procesverbal.

Neni 20
Këshilli shkencor

1. Këshilli shkencor është organ profesional-shkencorë i Institutit që:
 - 1.1. Shqyrton dhe vendos për çështjet shkencore dhe profesionale;
 - 1.2. Propozon kandidatët për drejtor-re të Institutit;
 - 1.3. Mbikëqyr dhe zbaton procedurën e zgjedhjes/rizgjedhjes në tituj shkencor dhe hulumtues;
 - 1.4. Kryen edhe punë të tjera në pajtim me Ligjin dhe Statutin e Institutit.
2. Këshillin shkencor e përbëjnë:
 - 2.1. Punonjësit shkencor dhe hulumtuesit të Institutit.
3. Mbledhjet e Këshillit shkencor i thërret dhe i udhëheqë drejtori-ja i Institutit.
4. Në rast të mungesës objektive të drejtorit-es ose në rastet kur drejtori-ja mund të jetë në konflikt interesi, Këshillin shkencor e thërret dhe udhëheqë Sekretari shkencor.

Neni 21
Kompetencat e Këshillit shkencor

1. Këshilli shkencor ka këto kompetenca:
 - 1.1. Emëron komisionin profesional për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së drejtorit-es;
 - 1.2. Emëron Komisionin recensues profesional, i cili zbaton procedurën e konkursit të zgjedhjes/rizgjedhjes dhe pranimin në punë të punonjësve shkencorë dhe hulumtuesve;
 - 1.3. Shqyrton dhe vendos planin e punës kërkimore-shkencore dhe të veprimtarisë botuese të Institutit;
 - 1.4. Shqyrton dhe vendos për çështjet shkencore dhe profesionale;
 - 1.5. Miraton raportin e punës kërkimore-shkencore të Institutit;
 - 1.6. Miraton raportet individuale të punës kërkimore-shkencore dhe profesionale të punonjësve shkencor dhe hulumtuesve të Institutit;
 - 1.7. Këshilli shkencor miraton anëtarët e redaksive të revistave dhe të botimeve të tjera të Institutit të propozuara nga drejtori-ja i Institutit;
 - 1.8. Miraton-zgjedhë sekretarin shkencor, pas propozimit nga drejtori-ja.
 - 1.9. Miraton-zgjedhë shefat e departamenteve Shkencore, pas propozimeve nga drejtori-ja dhe anëtarët e tjerë të Këshillit shkencorë.
 - 1.10. Shqyrton nevojat për aftësimin e kuadrove shkencore dhe profesionale;
 - 1.11. Këshilli shkencor harton rregulloren e vet të punës, bazuar në këtë statut dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 22

Komisioni profesional-shkencor për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së drejtorit-es

1. Komisioni profesional-shkencor për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së drejtorit-es zgjedhet nga Këshilli shkencor;
2. Komisioni përbëhet prej pesë (5) anëtarëve.
3. Këshilli Shkencor zgjedh dy (2) anëtarë të brendshëm të Institutit nga radha e punonjësve shkencore.
4. Kryetari i Komisionit zgjedhet njëri nga anëtarët, të cilin e zgjedh Këshilli shkencorë.
5. Këshilli Shkencor kërkon nga Ministria përkatëse për shkencë emërimin e dy (2) anëtarëve.
6. Këshilli Shkencor kërkon nga njëri prej Instituteve tjera për shkencë emërimin e një (1) anëtari
7. Komisioni duhet të harton listën e kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kushtet e përgjithshme dhe ato të veçanta, në pajtim me Legjislacionin në fuqi, Statutin e Institutit dhe konkursin;
8. Anëtarët e komisionit recensues kanë përgjegjësi për zbatimin e drejtë dhe të paanshëm të të gjitha dispozitave të “Ligjit për veprimtari kërkimore-shkencore” dhe “Statutit” të Institutit. Dështimi i zbatimit ligjor të këtyre dispozitave nënkupton shkelje dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë e kandidatit për pozitën përkatëse.
9. Komisioni, në afat prej dy (2) ditë pune nga mbyllja e konkursit merr në dorëzim dosjet e kandidatëve për drejtor-re, me ç’rast edhe fillon punën e tij;
10. Komisioni, në afat prej (10) ditë pune nga marrja në dorëzim të dosjeve, shqyrton dokumentacionin e kandidatëve, dhe i paraqet Këshillit shkencor të Institutit vlerësimin shkencor e profesional për secilin kandidat të paraqitur;
11. Në mbështetje të këtij vlerësimi, Këshilli shkencor i Institutit, në afat prej dy (2) ditë pune, i propozon Këshillit drejtues të Institutit kandidatët për drejtor-re të Institutit.

Neni 23

Drejtori, zgjedhja dhe mandati

1. Drejtori-ja i Institutit është organ individual i qeverisjes së Institutit;
2. Drejtor-re zgjedhet personi i cili, krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet t’i përmbushë edhe këto kushte të veçanta:
 - 2.1. Të jetë doktor i shkencave të historisë, përkatësisht të ketë njërin nga titujt shkencorë: Bashkëpunëtor shkencorë; Bashkëpunëtor i lartë shkencorë dhe Këshilltar shkencorë;
 - 2.2. Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune në lëmin e punëve kërkimore-shkencore;
 - 2.3. Të ketë cilësi dhe aftësi menaxhuese;
 - 2.4. Kandidati me rastin e konkurrimit, duhet të paraqesë program propozimin për punën 4-vjeçare për zhvillimin e punës kërkimore shkencore të Institutit.
3. Drejtori-ja i Institutit zgjedhet në bazë të konkursit publik të cilin e shpall këshilli drejtues pas aprovimit nga ana e MASHTI.
4. Drejtorin-en e Institutit e zgjedh dhe e shkarkon Këshilli drejtues i Institutit, në bazë të propozimit të Këshillit shkencor të Institutit.

5. Këshilli Drejtues ka të drejtë t'i anulojë propozimet e Komisionit profesional-shkencor për zbatimin e procedurës së përzgjedhjes së Drejtorit, në rast se konstaton se janë shkelur dispozitat ligjore në zhvillim të procedurës.
6. Ministria ka të drejtë të revidojë apo të anuloj vendimin e Këshillit drejtues kur konstatohet se janë shkelur dispozitat ligjore për zgjedhjen apo shkarkimin e drejtorit-es të Institutit.
7. Në rast të dështimit të zgjedhjes së drejtorit-es, Këshilli drejtues përsërit procedurat nga fillimi.
8. Mandati i drejtorit-es është katër vjet, me mundësi zgjedhje edhe për një mandat tjetër.
9. Drejtori shkarkohet nga detyra e caktuar para kalimit të afatit:
 - 9.1. Nëse Këshilli Shkencor konsideron se nuk i kryen si duhet punët që i janë besuar dhe kur ai me veprimet e tij ndikon negativisht në punën e tërësishme të Institutit
 - 9.2. Nëse shkelë rendë ose shkele vazhdimisht dispozitat, që i përkasin punës së Institutit;
 - 9.3. Sipas kërkesës së tij;
 - 9.4. Kur i pushon marrëdhënia e punës (për shkak të pensionimit);
 - 9.5. Në rastet e tjera të parashikuara me ligj;
10. Iniciativën për shkarkimin e drejtorit mund ta bëjnë: Këshilli Shkencor dhe Këshilli Drejtues;
11. Vendimin për shkarkim e merr Këshilli Drejtues i Institutit;
12. Në asnjë rast shkarkimi i drejtorit nuk mund të iniciohet pa plotësimin e kushteve të parapara në statut.

Neni 24

Kompetencat e drejtorit-es

1. Drejtori-ja i Institutit përveç kompetencave të përcaktuara me Ligj ka edhe këto kompetenca:
 - 1.1. Udhëheq dhe e përfaqëson Institutin dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së Institutit;
 - 1.2. Kryeson Këshillin drejtues, si dhe përkujdeset për zbatimin e vendimeve të tyre;
 - 1.3. Kryeson Këshillin shkencor; si dhe përkujdeset për zbatimin e vendimeve të tyre;
 - 1.4. Është urdhërues dhe përgjegjës për zbatimin e Planit-programit të Institutit;
 - 1.5. Është urdhërues dhe përgjegjës për zbatimin e Planit financiar të Institutit;
 - 1.6. Është kryeredaktor i Revistës Kosova dhe botimeve të Institutit.
 - 1.7. Për botime të veçanta drejtori-ja mund të propozoj redaktorë përgjegjës shkencor të cilët zgjidhen nga Këshilli shkencor.
 - 1.8. Formon grupe punuese dhe komisione për shqyrtimin e çështjeve nga fushëveprimtaria e Institutit.
 - 1.9. Përgatit organogramin dhe numrin e punonjësve të Institutit dhe ja propozon Këshillit Drejtues për miratim;
 - 1.10. Shpall konkurset për vendet e punës në njësinë e administratës dhe përkujdeset për zhvillimin e procedurave sipas Ligjit;
 - 1.11. Nënshkruan kontratat e punës me punonjësit e Institutit dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen procedurale sipas Ligjit dhe këtij statuti;
 - 1.12. Inicion dhe propozon zhvillimin e bashkëpunimit kërkimor-shkencor me Institucione kërkimore – shkencore në nivel vendi dhe ndërkombëtar;
 - 1.13. Lidhë marrëveshje në emër të Institutit;
 - 1.14. Vendos për blerjen dhe shfrytëzimin e mjeteve themelore të punës dhe mjeteve të tjera për nevoja të Institutit;
 - 1.15. Kujdeset për informimin e punonjësve dhe organeve të Institutit, si dhe opinionit publik lidhur me veprimtarinë e Institutit.

Neni 25
Përgjegjësitë e drejtorit-es

1. Drejtori-ja për punën e vet i përgjigjet Këshillit drejtues në pajtim me dispozitat e këtij Ligji dhe dispozitat e Statutit të Institutit.
2. Drejtori-ja së paku një herë në vit i paraqet Këshillit shkencor raport për punën e tij dhe veprimtarinë e tërësishme të Institutit.
3. Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligj dhe me këtë Statut.

Neni 26
Zëvendësuesi i drejtorit-es

1. Në qoftë se drejtori-ja nuk emërohet në kohën e duhur, apo për çfarëdo rrethane tjetër pozita e drejtorit-es mbetet vakante për më shumë se një muaj (30 ditë), caktohet Zëvendësuesi i drejtorit-es.
2. Zëvendësuesin e drejtorit-es e zgjedh Këshilli drejtues, nga radha e punonjësve shkencorë të Institutit.
3. Zëvendësuesi i drejtorit-es i ka të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë e drejtorit-es.
4. Mandati i Zëvendësuesit të drejtorit-es mund të zgjasë deri në gjashtë muaj me mundësi vazhdimi vetëm edhe për 6 muaj të tjerë.

Neni 27
Sekretari shkencor

1. Sekretari shkencor i Institutit, krahas detyrave të tij të punonjësit shkencor (nga marrëdhënia e punës), kryen edhe këto detyra:
 - 1.1. Bashkërendon veprimtarinë shkencore e profesionale me drejtorin-en, Këshillin shkencor dhe Shefat e departamenteve;
 - 1.2. Në rast të mungesës objektive të drejtorit-es ose në rastet kur drejtori-ja mund të jetë në konflikt interesi, detyrën e drejtorit-es e ushtron Sekretari shkencor;
 - 1.3. Bashkërendon veprimtarinë botuese të Institutit;
 - 1.4. Përkujdeset për organizimin e aktiviteteve shkencore që mbahen në nivel të Institutit;
 - 1.5. Sekretari shkencor kompensohet sipas legjislacionit në fuqi.
2. Sekretari shkencor emërohet nga radha e punonjësve shkencorë të Institutit.
3. Sekretari shkencor emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli shkencor pas propozimit të drejtorit-es.
4. Sekretari shkencor i përgjigjet dhe i raporton drejtorit-es.
5. Sekretari shkencor është sekretar i çdo redaksie të botimeve të Institutit.
6. Sekretari shkencor është anëtar i Këshillit Organizues i të gjitha aktiviteteve shkencore të Institutit.
7. Sekretari shkencor zgjedhet me mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

PUNËTORËT SHKENCORË DHE HULUMTUESIT

Neni 28

Titujt shkencorë dhe hulumtues

1. Punonjësit që merren më punë kërkimore-shkencore në Institut dhe që i plotësojnë kushtet e parapara me Ligjin për veprimtari kërkimore-shkencore, me këtë Statut, dhe akte nënligjore, zgjedhën në tituj shkencor ose në tituj hulumtues.
2. Titujt shkencorë janë: Bashkëpunëtor shkencor, Bashkëpunëtor i larte shkencor dhe Këshilltar shkencor.
3. Titujt hulumtues janë: Hulumtues dhe Hulumtues i pavarur.
4. Titulli Bashkëpunëtor shkencor është i barasvlershëm me titullit shkencor-mësimor Asistent profesor; titulli Bashkëpunëtor i larte shkencor është i barasvlershëm me titullit shkencor-mësimor Profesor i asocuar; titulli Këshilltar shkencor është i barasvlershëm me titullit shkencor-mësimor Profesor i rregullt.
5. Titulli Hulumtues është i barasvlershëm me titullit Asistent i ri, titulli Hulumtues është i barasvlershëm me titullit Asistent.
6. Me qëllim që të rinjtë të përgatiten, të aftësohen dhe të përfshihen në punën kërkimore-shkencore, në Institut mund të pranohen edhe praktikantë.

Neni 29

Zgjedhja dhe rizgjedhja në titujt shkencorë

1. Bashkëpunëtor shkencor, në kohëzgjatje prej katër (4) vjetësh, mund të zgjedhet personi që ka shkallën e doktorit të shkencave, që ka botuar së paku një (1) punim shkencor, në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare.
2. Bashkëpunëtor i lartë shkencor, në kohëzgjatje prej 4 vjetësh zgjidhet personi që ka arritur gradën shkencore të doktorit të shkencave, i cili ka botuar së paku një vepër shkencore monografike, dhe që ka botuar së paku 3 punime shkencore në revista relevante ndërkombëtare në kuadër të fushës, 2 prej tyre pas zgjedhjes së fundit.
3. Këshilltar shkencor zgjidhet personi që ka arritur gradën doktor i shkencave, i cili ka botuar së paku dy vepra shkencore monografike, njëra pas zgjedhjes së fundit, që ka botuar së paku 5 punime shkencore në revista relevante ndërkombëtare në kuadër të fushës, 2 prej tyre pas zgjedhjes së fundit, dhe që ka marrë pjesë me sukses në organizimin e veprimtarisë shkencore.
4. Titulli këshilltar shkencor është i përhershëm;
5. Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension përcaktohen nga Ministria përkatëse për shkencë.

Neni 30

Zgjedhja në titujt hulumtues

1. Hulumtues, në kohëzgjatje prej tri (3) vjetësh, zgjidhet personi me studime përkatëse themelore me notë mesatare tetë (8) e sipër dhe që ka kryer studimet për master shkencor, që nuk ka më shumë se njëzet e shtatë (27) vjet.
2. Hulumtues i pavarur, në kohëzgjatje prej tri (3) vjetësh, zgjidhet personi që ka regjistruar studimet e doktoratës dhe që ka punime të publikuara në revista shkencore.
3. Mandati i hulumtuesit të pavarur është 3 vjet më të drejtë rizgjedhje edhe për një mandat. Përgjashtimisht hulumtuesi i pavarur i cili është rizgjedhur për mandatin e dytë, mund ti hapet konkursi për tu avancuar në thirrjen bashkëpunëtor shkencor pa e konsumuar mandatin me rastin kur konstatohet-vlerësohet që i plotëson kriteret.

4. Hulamtuesit nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni mund të zgjedhën në titullin e njëjtë edhe për një mandat.
5. Në rast të rrethanave të cilat hulamtuesi i pavarur është në procedurën përfundimtare të mbrojtjes së temës së doktoratës të cilat i udhëheq Universiteti përkatës, të njëjtit do t'i vazhdohet pozita në Institut, për një periudhë dy vjeçare.
6. Hulamtuesit dhe hulamtuesit të pavarur do t'i caktohet një mentor nga radhët e punonjësve shkencor të Institutit, për realizimin e objektivave të tij/saj në avancimin shkencor.

Neni 31 **Profesor/e Emeritus**

1. "Profesorit/es të rregulltë-Këshilltarit/es shkencor" të pensionuar të Institutit, mund t'i caktohet titulli i përhershëm "Profesor/e Emeritus-Këshilltar/e Emeritus" për merita të veçanta institucionale dhe shkencore nga ana e Këshillit shkencor, me propozimin recensues të së paku dy (2) departamenteve përkatëse shkencore.
2. Profesori/ja Emeritus-Këshilltari/ja Emeritus obligohet që: gjatë vitit kalendarik të dorëzoj në dorëshkrim një punim për revistën shkencore "Kosova" dhe të marrë pjesë në një Konferencë shkencore të Institutit; në çdo periudhë katër (4) vjeçare të dorëzoj në dorëshkrim një monografi shkencore autoriale apo redaktoriale-respektivisht vëllim me dokumente historike; si dhe Profesori/ja Emeritus-Këshilltari/ja Emeritus duhet të shërbejë pa pagesë sipas kërkesës së Institutit në Komisionet recensuese, komisione të tjera dhe këshilla përkatëse të Institutit.
3. Profesori/ja Emeritus-Këshilltari/ja Emeritus përfiton shtesë mujore prej 20% të pagës bazë të Këshilltarit shkencor-Profesorit të rregullt. Pagesa e Profesorit/es Emeritus-Këshilltarit/es Emeritus realizohet bazuar në Ligjin për paga të sektorit publik, nenit 32.2.
4. Në rast të mos përmbushjes së obligimeve të tij, Profesorit/es Emeritus-Këshilltarit/es Emeritus i ndalet pagesa deri me plotësimin e obligimeve të tij/saj.

Neni 32 **Lidhja dhe shkëputja e marrëdhënies së punës**

1. Punëtorët shkencorë dhe hulamtuesit lidhin me Institutin kontratën për punën në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Kontrata e punës e lidhur midis punëtorit shkencor ose hulamtuesit dhe Institutit shkëputet:
 - 2.1. Me kërkesën e punëtorit shkencor ose të hulamtuesit;
 - 2.2. Në qoftë se punëtori shkencor ose hulamtuesi e humb statusin e punëtorit shkencor, për shkak se nuk zgjedhet ose rizgjedhet në titullin e paraparë;
 - 2.3. Nëse punonjësi shkencor ose hulamtuesi dështon në realizimin e obligimeve të përcaktuara në kontratë;
 - 2.4. Nëse punonjësi shkencor ose hulamtuesi nuk i përmbushë kushtet sipas dispozitës përkatëse mbi normën e punës;
 - 2.5. Nëse punonjësi shkencor ose hulamtuesi nuk e realizon qëllimisht apo e neglizhon realizimin e projektit shkencor;
 - 2.6. Nëse punonjësi shkencor ose hulamtuesi në vlerësimin e performansës së punës nuk e realizon planin e punës dhe projektin kërkimor;
 - 2.7. Nëse shkel kodin e etikës së punonjësit të Institutit;
 - 2.8. Në qoftë se punëtori i shkel rëndë detyrat e punës, ose me sjelljet e tij e ul autoritetin e Institutit;

- 2.9. Zgjedhja e punonjësve shkencor dhe hulumtues të Institutit bëhet në bazë të konkursit publik;
- 2.10. Në rastet e tjera të përcaktuara me ligj.
- 2.11. Kontrata e punës me punonjëset e tjerë ndërpritet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 33

Marrja e vendimit për konkurs për zgjedhje dhe rizgjedhje në titujt shkencorë dhe hulumtues

1. Vendimin për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e rizgjedhjen e punonjësve shkencorë dhe të hulumtuesve e merr Këshilli shkencor.
2. Procedura e zgjedhjes-rizgjedhjes së punonjësit shkencor dhe hulumtuesit zbatohet në harmoni me “Ligjin për veprimtari kërkimore-shkencorë”, të këtij “Statuti” dhe “Rregullores për zgjedhje dhe rizgjedhje të punonjësve shkencor dhe hulumtues”.
3. Vendimi për zgjedhje/rizgjedhje merret gjashtë muaj para skadimit të afatit të kontratës së punonjësit shkencor ose të hulumtuesit.
4. Konkursi duhet të përsëritet nëse asnjëri nga kandidatët nuk i plotëson kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi.

Neni 34

Komisioni recensues

1. Këshilli shkencor është i obliguar që për çdo pozitë të shpallur në konkurs ta caktojë Komisionin recensues, respektivisht kryetarin dhe anëtarët.
2. Komisioni recensues profesional, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përbëhet prej tre anëtarëve, dy prej të cilëve duhet të jenë nga fusha e ngushtë profesionale, anëtari i komisionit mund të jetë edhe i jashtëm,
3. Mendimin se kandidati i përmbush ose jo kushtet për zgjedhje në titullin shkencor ose në titullin hulumtues, e jep komisioni recensues, i cili zbaton procedurën e konkursit.
4. Komisioni recensues profesional përbëhet së paku prej tre (3) anëtarëve, dy (2) prej të cilëve duhet të jenë nga fusha e ngushtë profesionale dhe nuk bën të jenë me tituj më të ulët se titulli për të cilin e shkruajnë recensionin.
5. Anëtarët e komisionit recensues kanë përgjegjësi për zbatimin e drejtë dhe të paanshëm të të gjitha dispozitave të “Ligjit për veprimtari kërkimore-shkencorë”, “Statutit” të Institutit dhe “Rregullores për zgjedhje dhe rizgjedhje”. Dështimi i zbatimit ligjor të këtyre dispozitave nënkupton shkelje dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë e kandidatit për pozitën përkatëse.

Neni 35

Referati i komisionit

1. Referati i komisionit duhet të përmbajë:
 - 1.2. Shënimet biografike dhe bibliografike të kandidatit;
 - 1.3. Vlerësimin e punës së tij/saj shkencore;
 - 1.4. Propozimin për zgjedhje/rizgjedhje.
2. Komisioni recensues, me rastin e dhënies së propozimit për zgjedhjen/rizgjedhjen e punonjësit shkencor dhe hulumtuesve, duhet të ketë parasysh dispozitat ligjore dhe aktet e tjera nënligjore, për vlerësimin e punës kërkimore-shkencore.

3. Kryetari i komisionit recensues është i obliguar të thërrasë anëtarët e tjerë të Komisionit dhe ta hartojnë raportin e vlerësimit (Referatin) për kandidatët e paraqitur në konkurs, të cilin ja dorëzojnë Këshillit shkencor.
4. Referati, sipas paragrafit 1 të këtij neni, publikohet në web-faqe të Institutit-për 15 ditë kalendrike para marrjes së vendimit nga Këshilli shkencor.
5. Këshilli shkencor i Institutit, në bazë të mendimit të Komisionit recensues, merr vendim për zgjedhjen-rizgjedhjen e kandidatit të propozuar në titullin përkatës shkencor ose hulumtues.
6. Në rastet kur Komisioni recensues, respektivisht ndonjë prej anëtarëve të Komisionit, nuk i përfill kriteret dhe procedurat e vlerësimit, drejtori-ja inicion zëvendësimin e tij/saj.
7. Procedura e konkursit duhet të përfundojë brenda afatit prej tre muajsh.
8. Procedura e zgjedhjes dhe rizgjedhjes rregullohet me Ligj, këtë Statut dhe Rregulloren për zgjedhjen dhe rizgjedhjen e punonjësve shkencorë dhe hulumtues.

Neni 36

Angazhimi dhe aftësimi i praktikantëve në Institut

1. Instituti, në bazë të planifikimit vjetor për përgatitjen dhe aftësimin e kuadrit të ri shkencor, pranon praktikantë, me qëllim të aftësimit dhe përgatitjes shkencore e profesionale të tyre.
2. Praktikant mund të zgjedhet personi me studime përkatëse themelore, me notë mesatare tetë (8) e sipër;
3. Praktikant mund të zgjedhet personi që nuk ka më shumë se njëzet e katër (24) vjet;
4. Praktikanti zgjedhet në kohëzgjatje prej 1 vit me mundësi të vazhdimin të angazhimit edhe për një vit tjetër;
5. Gjatë periudhës së angazhimit, praktikantët do të angazhohen në projektet kërkimore të departamentit përkatës, për të cilët do të përkujdeset Shefi i departamentit.
6. Praktikanti do të punoj si asistent për zbatimin e projekteve shkencore të Institutit të Historisë dhe punonjësve shkencor nën direktivat e tyre.
7. Paga e praktikantit do të jetë e barasvlershme me pagën mesatare në Kosovë.
8. Instituti nuk ka asnjë obligim punësimi pas përfundimit të praktikës së tyre.
9. Procedura e pranimit të praktikanteve-stazhiereve zhvillohet njësoj sikur për zgjedhjen e punonjësve shkencore dhe të hulumtuesve.

Neni 37

Publikimi i të dhënave

1. Instituti ka për detyrë t'i publikojë në web-faqen e tij
 - 1.1. Ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme;
 - 1.2. Strategjinë e zhvillimit shkencor të Institutit;
 - 1.3. Strukturën e vendeve të punës të punonjësve të Institutit;
 - 1.4. Informacionin për anëtarët e organeve qeverisëse, shkencore dhe profesionale të Institutit dhe kohëzgjatjen e mandatit të tyre;
 - 1.5. Rregullat dhe procedurat që rregullojnë funksionimin e organeve vendimmarrëse të Institutit;
 - 1.6. Rezultatet e kontrolleve të brendshme dhe të jashtme të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit të saj në përputhje me dokumentet ligjore që rregullojnë sigurimin e cilësisë në fushën e shkencës dhe të arsimit;
 - 1.7. Kodin e etikës;
 - 1.8. Dokumentet dhe aktet e tjera që janë në interes të informimit të opinionit të gjerë.

2. Instituti duhet të publikojë në web-faqen e tij edhe këto informacione:
 - 2.1. Raportin mbi ecurinë e aktiviteteve dhe projekteve kërkimore-shkencore;
 - 2.2. Marrëveshjet e veçanta programore të lidhura me ministrine për shkence dhe partnerë të tjerë bashkëpunues;
 - 2.3. Listën e punëtorëve shkencorë dhe të hulumtuesve si dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm;
 - 2.4. Informacione të tjera që dalin nga aktet e përgjithshme dhe nga Strategjia zhvillimore e Institutit.

Neni 38

Promovimi i punës së Institutit

1. Instituti është i detyruar të informojë publikun drejtë dhe me kohë për aktivitetet për të cilat është themeluar.
2. Informimi i publikut mund të bëhet përmes web-faqes zyrtare, medie të shkruara dhe elektronike, etj.
3. Vetëm drejtori-ja apo punonjësit e autorizuar mund të informojnë publikun për veprimtarinë e Institutit përmes medimeve të përcaktuara më lartë.

Neni 39

Biblioteka

1. Instituti ka Bibliotekën e vet, që është pjese përbërëse e departamentit për shërbime të përgjithshme.
2. Punët profesionale të bibliotekarisë i kryejnë punëtorët profesionalë të Bibliotekës.
3. Organizimi dhe puna e Bibliotekës përcaktohen me rregullore të veçantë.

Neni 40

Arkivi

1. Arkivi i Institutit është pjese përbërëse e departamentit për shërbime të përgjithshme.
2. Arkivi mbledh, rregullon, përpunon dhe ruan lëndën arkivore të mbledhur gjatë punës kërkimore –shkencore, si dhe materiale të tjera me rendësi shkencore: dorëshkrime të autorëve, punonjësve shkencorë të Institutit dhe bashkëpunëtorë të jashtëm.
3. Punët profesionale i kryejnë punëtorët profesionalë të Arkivit.
4. Organizimi dhe puna e Arkivit më hollësisht përcaktohen me rregullore të veçantë.
5. Arkivin e përbëjnë dokumentet fizike, të dixhitalizuara dhe dokumentet e tjera të punës kërkimore të punonjësve shkencorë dhe hulumtues të Institutit.

Neni 41

Plani dhe programi i punës

1. Plani i objektivave (3) vjeçar dhe afatgjatë-strategjik (6) vjeçar i zhvillimit institucional do të prezantohet nga drejtori/ja i/e zgjedhur për miratim nga Këshilli shkencor dhe Këshilli drejtues i Institutit.
2. Harmonizimi i programit dhe planit të punës të Institutit realizohet nëpërmjet drejtorit/es të Institutit, pas paraqitjes së propozimeve të punonjësve shkencor dhe departamenteve shkencore. Me këtë rast, dokumenti i harmonizuar nga ana e drejtorit/es do të paraqitet, në dhjetor të çdo viti paraprak, pranë Këshillit shkencor për miratim profesional dhe për aprovim në aspektin financiar nga ana e Këshillit drejtues të Institutit.

3. Drejtori-ja do t'i prezantoj këshillit shkencorë për miratim plan-programet e harmonizuara të departamenteve duke marrë parasysh mundësitë e realizimit në aspektin cilësor dhe sasiorë.
4. Dokumenti final i plan programit të punës i miratuar nga Këshilli shkencor do të jetë udhëzues i punës kërkimore, shkencore dhe veprimtarisë botuese të Institutit.
5. Me planin dhe programin e punës, Instituti inkuadrohet ne Programin Kombëtar Kërkimor-Shkencor të Kosovës.
6. Instituti miraton planet e programet e punës afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.
7. Dokumenti final i plan programit të punës i miratuar nga Këshilli shkencor do të jetë udhëzues i punës kërkimore, shkencore dhe veprimtarisë botuese të Institutit.
8. Punonjësi shkencor dhe hulumtuesi i Institutit është i obliguar që në fund të vitit ti dorëzojnë drejtorit-es raportet e punës për vitin kalendarik dhe planifikimet shkencore për vitin pasues.
9. Punonjësit shkencor dhe hulumtues veprimtarinë e tyre kërkimore-shkencore të realizuar gjatë një viti kalendarik duhet ta arsyetojnë me vërtetime përkatëse për realizimin e vëllimit të punës të lëshuar nga ana e departamenteve shkencore. Propozimet e planit të punës, raportet e punës dhe vërtetimet mbi realizimin e punës do të regjistrohen e protokolothen në një libër të veçantë " Protokoli i realizimit të plan-programit të punës kërkimore-shkencore".
10. Punëtori shkencor obligohet që brenda një viti kalendarik të realizojë vëllimin e punës individuale shkencore në dorëshkrim deri në tre (3) tabak (48 faqe A4 - times new roman 12pt, line 1.15). Përbërja e këtij vëllimi të punës përfshinë një punim në dorëshkrim deri në një (1) tabak të dorëzuar për botim në revistën shkencore të Institutit "Kosova", i cili do t'i nënshtrohet vlerësimit të recensionit dhe përshtatshmërisë për botim. Po ashtu deri në dy (2) tabak do të realizohen si vijon: për përpunimin e dokumenteve arkivore historike - pjesë përbërëse e punës kërkimore-shkencore; krijimtari nga puna shkencore në projekt individual apo të përbashkët i cili është pjesë e plan-programit të punës së Institutit; si dhe punime të kritikës historiografike, recensë e veprës së botuar, punim ndërkombëtar apo kumtesë e Konferencës shkencore.
11. Hulumtuesit obligohet që brenda një viti kalendarik të realizojë vëllimin e punës individuale profesionale prej dy (2) tabakë (32 faqe A4 - times new roman 12pt, line 1.15). Përbërja e punës profesionale-shkencore do të përcaktohet në bashkëveprim me mentorin dhe departamentin respektiv shkencor.
12. Punimi i punonjësit shkencor dhe hulumtues i referuar në Konferencë shkencore, i cili përmban aparatit shkencor dhe është publikuar nga institucioni kërkimor-shkencor, cilësohet dhe i ka të njëjtat attribute të punimit shkencor për nevoja të avancimit shkencor.
13. Botimet e përgjithshme vjetore të punonjësit shkencor dhe hulumtuesit do të llogariten si vëllim i punës së përmbushur.
14. Praktikanti obligohet që brenda një viti kalendarik të realizojë vëllimin e punës individuale profesionale prej dy (2) tabakë (32 faqe, A4 - times new roman 12pt (line 1.15). Përmbajtja e punës përkrasë profesionale do të përcaktohet nga mentori dhe departamenti respektiv shkencor.
15. Punëtori shkencor, i cili ushtron detyrën e drejtorit-es është i liruar në masë 70% të vëllimit të punës, ndërsa punëtori shkencor i cili ushtron detyrën e sekretarit shkencor është i liruar në masë 50% nga vëllimi i punës shkencore.
16. Mbikëqyrja e realizimit të vëllimit të punës shkencore të përcaktuar me këtë Statut dhe pjesë përbërëse e plan-programit të miratuar të punës, do të zbatohet nga departamenti respektiv shkencor në të cilin bënë pjesë punonjësi shkencor apo hulumtuesi.

Neni 42

Veprimtaria financiare e Institutit

1. Institutit financohet nga këto burime financiare:
 - 1.1. Nga Buxheti i Kosovës;
 - 1.2. Të hyrat vetanake;
 - 1.3. Të hyrat vetanake nga shitblerja-paratë e imta të tirazhit të librave të botuara nga Institutit, të cilat do të shfrytëzohen për hulumtime shkencore-arkivore.
 - 1.4. Nga Donacionet dhe të tjera.
2. Institutit planifikon buxhetin sipas burimeve të financimit dhe kategorive të shpenzimeve buxhetore në sistemin e zhvillimit dhe menaxhimit të buxhetit (SZHMB) dhe programi për investime publike (PIP), bazuar në legjislacionin në fuqi që rregullon menaxhimin e financave publike dhe buxhetin vjetor.
3. Institutit harton planin e vet financiar, të cilin e miraton Këshilli drejtues, për të cilin pëlqimin paraprak e jep Ministria përkatëse për shkencë;
4. Plani financiar merr për bazë kërkesat e departamenteve, detyrimet nga politikat dhe Strategjitë zhvillimore të Institutit, detyrimet nga plan-programi Kombëtar i Shkencës dhe kërkesat e vendit;
5. Realizimi i planit financiar konstatohet me raportin financiar vjetor në fund të vitit, të cilin e miraton Këshilli drejtues;
6. Mjetet e Institutit përdoren vetëm për dobi të Institutit dhe për qëllime e detyra të përcaktuara me këtë Statut;
7. Plani financiar përpilohet nga drejtori-ja i Institutit.

Neni 43

Mjetet Financiare

1. Mjetet, financiare për veprimtari të rregullt të Institutit përfshijnë:
2. Mjetet për projekte shkencore.
3. Mjetet për pagat e punonjësve të Institutit.
4. Mjetet për realizimin e programit të punës kërkimore - shkencore të Institutit.
5. Mjetet për shpenzimet materiale dhe administrative të Institutit.
6. Mjetet për veprimtari botuese.
7. Mjetet për aktivitetet shkencore.
8. Mjetet për Bibliotekën dhe Arkivin e Institutit.
9. Mjetet për ekspedita shkencore në terren dhe për hulumtime shkencore në biblioteka dhe arkiva në vend dhe në botën e jashtme.
10. Mjetet për bashkëpunim ndërkombëtar.
11. Mjetet për aftësimin e kuadrit shkencor.
12. Mjetet për pajisje dhe për mirëmbajtjen investuese të ndërtesës dhe të pajisjeve të Institutit.

Neni 44

Pasuria e Institutit

1. Institutit është titullar i patundshmërisë, sipas fletës poseduese nr. 996 (i ngastrës kadastrale, P-71914059-0 7090-19, ndërtesës dhe pjesëve të ndërtesës), i bibliotekës, i koleksioneve shkencore, arkivore e artistike, si dhe i gjësendeve të tjera, të cilat i ka siguruar nëpërmjet blerjes, donacioneve ose në ndonjë mënyrë tjetër, dhe kujdeset në përputhje me ligjin.

Neni 45
Dispozitat kalimtare

1. Instituti harmonizon aktet e përgjithshme juridike me dispozitat e këtij Statuti dhe bënë organizimin e punës së vet brenda gjashtë muajsh që nga dita e hyrjes së tij në fuqi.
2. Procedurat e zgjedhjes dhe të rizgjedhjes së punonjësve shkencorë, që kanë filluar para hyrjes në fuqi të këtij Statuti, do të përfundojnë sipas dispozitave që kanë qenë në fuqi në çastin e fillimit të procedurës, nëse nuk janë në kundërshtim me ligjin.

Neni 46
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohet Statuti i dt. _____

Neni 47
Dispozitat e hyrjes në fuqi

Ky Statut do të hyjë në fuqi pasi ta ketë dhënë pëlqimin paraprak MASHTI dhe pasi të jetë miratuar nga Këshilli drejtues i Institutit. Miratimi i Statutit nga Këshilli drejtues duhet të bëhet më së voni tridhjetë (30) ditë pas marrjes së pëlqimit.

Nënshkruar nga Ministrja e MASHTI



Dt. ____/____/____
Prishtinë

Miratuar nga Këshilli drejtues i Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë

_____ **Kryesues**

Dt. 20/11/2024
Prishtinë

